



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



MNE - ALB


IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI 2014-2020

PËR FUNDJAVË NË ULQIN

— Tourist Guide —



Ky katalog publikohet në kuadër të projektit “Rrugët për zhvillimin e karrierës: Përgatitja e të rinjve në Shqipëri dhe Mal të Zi për mundësitë e karrierës në sektorin e turizmit” i cili realizohet me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - Programi IPA II për Bashkëpunim Ndërkufitar Mal i Zi – Shqipëri 2014-2020. Materiali u përgatit nga nxënësit dhe mësimdhënësit e Shkollës së Mesme të Kombinuar “Vëllazërim Bashkim” Ulqin. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e OJQ Horizonti i Ri dhe nuk pasqyron detyrimisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.




Territori i komunës së Ulqinit shtrihet në pjesën jugore të Malit të Zi, një zonë në bregun lindor të Adriatikut. Komuna e Ulqinit shtrihet në një sipërfaqe prej 255 km². Në perëndim dhe në veri kufizohet me komunën e Tivarit, kurse në lindje me Shqipërinë. Nga ana gjeografike komunën e Ulqinit mund ta ndajmë në dy zona: zona bregdetare dhe zona e Anës Malit.


Për ata që kërkojnë qetësi dhe të largohen nga rutina e qytetit, pas pikës kufitare në Sukubinë, turistët kanë mundësi të vizitojnë zonën e Anës së Malit. Në këtë zonë mund të vizitoni:

Muzeun Etnografik në Draginë - i vetmi i këtij lloji në komunën e Ulqinit. Ka disa vite që krijuesit e këtij muzeu merren me mbledhjen e objekteve të vjetra, duke e shndërruar këtë shtëpi të vjetër në një muze të mirëfilltë. Vizitorët në këtë muze mund të shohin ekspozime të ndryshme, të rralla dhe me vlera të mëdha historike.

Ambienti i rrethuar nga gjelbërimi mbresëlënës dhe ajri i freskët të drejton tek një restorant mjaft i njohur për nga specialitetet e ndryshme të gatimit i cili ndodhet në kilometrin e pestë të rrugës së Ostrosit. Nëse dëshironi shumë qartë ta shihni pellgun e Lumit Buna, Liqenin e Shasit, Detin Adriatik dhe vijën kufitare Mali i Zi-Shqipëri, atëherë vendi ideal për ju është Restaurant „Panorama“ në fshatin Rashtishë. Në restorantin „Panorama“ ju mund të ushqeheni me një tavë peshku shumë të freskët nga Liqeni i Shkodrës.



Muzeun Etnografik në Draginë



SHASI, i njohur ndryshe edhe si qyteti mesjetar, gjendet në pjesën verilindore të Ulqinit në një lëndinë mbi Liqenin e Shasit. Tani Shasi është një fshat i njohur i Anës së Malit, kurse pjesa mesjetare e tij është e pabanuar nga njerëzit. Ka një pasuri shumë të madhe kulturoro-historike, dhe si i tillë konsiderohet si një ndër qytetet më atraktive “të vdekura”.



Shasi

Ura e Vjetër e Klleznës është një urë prej guri e ndërtuar në vitin 1696 mbi përroit e Megjureçit në Klleznën e Sipërme të Komunës së Ulqinit. Ajo është e gjatë 12 m, e gjërë 3,60 m, e lartë nga fundi i përroit 9.26 m dhe trashësia e gurëve te çelësi 80 cm. Për ndërtimin e kësaj ure ekziston një rrëfim interesant që u përcoll brez pas brezi deri në ditët tona. Thuhet se mjeshtri i cili e ka ndërtuar këtë urë ka qenë nga Dibra.



Ura e Vjetër e Klleznës

Duke u nisur për në zonën bregdetare në hyrje mund të vizitoni:

Hotel Lolla - ndodhet në një zonë të qetë, në periferi të Ulqinit, 2 km nga Plazhi i Madh. Përmban një pishinë të hapur, bar dhe restorant. Mysafirët mund të pushojnë në tarracën e për-bashkët me pamje nga pishina. Fëmijët mund të luajnë në sheshin e lojërave të hotelit. Restoranti i hotelit shërben kuzhinë tradicionale mesdhetare, dhe pijet lokale të zgjedhura mund të shijohen në bar.



Kriporja e Ulqinit bën pjesë në grupin e kriporeve më të mëdha në Mesdhe, e cila mbulon një sipërfaqe prej 14km². Ky vend, tani e 15 vitet e fundit, ka qenë habitati më i rëndësishëm për zogjtë në bregun lindor të Adriatikut, si për fole dhe dimërim, ashtu edhe si një vend pushimi gjatë migrimit.

Kriporja "Bajo Sekuliq" u ndërtua në rajonin me numrin më të madh të ditëve të kthjellëta, 2567 orë me diell dhe numrin më të madh të ditëve tropikale në ish-Jugosllavi. Ky lokalitet paraqet një nga pikat më të famshme turistike në Ulqin, sepse përveç një shëtitoreje të gjatë, ofron edhe huazim biçikletash me të cilat mund të vizitoni të gjithë zonën e Kripores. Flamingot e famshëm janë gjithashtu një atraksion i njohur, pasi kanë gjetur habitatin e tyre në Kripore. Po ashtu, rreth 250 lloje zogjsh janë banorë të kësaj zone.

Kriporja e Ulqinit



"Kallaba" Restoranti Express dhe Megamarketi - ka një sipërfaqe prej 400 m². Një hapësirë e rehatshme e pajisur dhe moderne i bën blerjet tuaja më të këndshme dhe ju ofron mundësi të shumta për relaksim dhe argëtim. Çmimet e favorshme, si dhe ofertat e gjera të produkteve nga prodhuesit vendas dhe të huaj, tërheqin shumë vizitorë çdo ditë nga Ulqini dhe zona përreth.



Qyteti i Vjetër i Ulqinit

Nëse në listën tuaj keni përgatitur roba banje, energji të mirë dhe dëshirën për t'u relaksuar nën rrezet e ngrohta të diellit, ose të paktën një darkë bregdetare, atëherë Qyteti i Vjetër - Kalaja e Ulqinit është ndërtuar për ju!

Një dylbi e vërtetë kulturore e historisë shumëshekullore, kullat e larta, muzeumet antike, shpellat mesjetare, restorante cilësore, krijojnë pamje që të lënë pa fjalë. Këto dhe shumë më tepër, janë të vendosura në kalanë e vetme në Adriatik, muret e së cilës ngrihen direkt nga deti. Një magji e vërtetë ju pret vetëm disa hapa nga Plazhi i Vogël.

Qyteti i Vjetër i Ulqinit





Pallati i Venecias, Kulla e Balshajve dhe gjithçka që pa Servantesi

Duke ecur nëpër rrugët ku ecte i famshmi Miguel de Cervantes, dëshira për arkitekturë por edhe njerëzit e mirë të Ulqinit do t'ju çojnë në një nga ndërtesat më të bukura në Qytetin e Vjetër, Kullën e Balshajve. Kjo kullë u ndërtua në fund të shekullit XIV dhe fillimit të shekullit XV, kur Ulqini ishte kryeqyteti i familjes së fuqishme të Balshajve.

Jo shumë larg tij, do të gjeni një pjesë të Venecias, me teknikat tipike arkitektonike veneciane të pallatit, jo në Republikën Veneciane, por në qytetin e bregdetit të Ulqinit në "Pallatin e Venecias". Përveç Muzeut Etnografik, i cili, i vendosur në Qytetin e Vjetër, u jep vizitorëve çelësat e historisë së Ulqinit, këto ndërtesa me tiparet e tyre mesjetare ofrojnë një pasqyrë të shpejtë të së kaluarës së largët.



Akomodim i rehatshëm dhe peshk i freskët në vaj ulliri - Ku të qëndroni dhe të drekoni?

Pas një dite të gjatë të kaluar në shkumën e detit dhe një shëtitje në mbrëmje në shëtitoren e Ulqinit, muret e Qytetit të Vjetër do t'ju drejtojnë në hotelet dhe apartamentet e tij më të mira si: Hoteli "Kulla e Ballshajve", Apartamente Antigona, Hoteli "Palata Venezia", Villa Marinero, Apartamente Timoni dhe shumë të tjerë. Dhe nëse para se të relaksoheni, ju doni ta përfundoni natën tuaj me darkën më të mirë mesdhetare ose një pije freskuese, përveç hoteleve të përmendura, ka plot restorante të njohura që do të plotësojnë kënaqësinë tuaj në det, të tillë si: Restorant Taphana, Restorant Dulcinea, Restorant Antigona, Restorant Hari, Restorant Teuta, Peshkatar Hari Restorant, Barbarossa Pirate Bar dhe shumë të tjerë.

Ejani në Qytetin e Vjetër!

Te forta si shkëmbi por me zemër të artë – Plazhet prej guri: Liman I, II, Valdanosi

Nëse hitet verore të vitit 2021 nuk janë muzikë për veshët tuaj, ne ju sugjerojmë të dëgjoni grupin e vjetër tradicional ulqinak - murmuritje deti, cicërima të zogjve dhe fishkëllimat e erës, nga shezllonat më të mira, direkt nga plazhi i Limanit. Jo shumë larg qytetit të vjetër të Ulqinit, është Liman I. Është një plazh i vogël shkëmbor ku mund të gjesh një restorant të këndshëm, si dhe shezllone në diell. Gjithashtu, kohët e fundit është shtuar një vend për lidhjen e një varke ose jahte, për të gjithë marinarët e apasionuar.

A ju pëlqen ky kombinim? Atëherë me siguri do t'ju pëlqejë edhe shtëpiza fqinje vetëm disa hapa larg - plazhi prej guri Liman II. Në skajet e këtij plazhi ka pllaka shkëmbi të mbuluara me shezllone të përshtatshme për diell. Një hotel modern, një restorant i shkëlqyeshëm si dhe një vend për lidhjen e një anijeje apo jahte, ju pret këtu në Liman II. Largimi nga kjo parajsë do të jetë e vështirë për ju.

Valdanosi




Dëshironi qetësi, një flad të këndshëm, det vezullues por edhe natyrë që të lë pa frymë dhe një aventurë të paharrueshme? A mendoni se kjo është një listë e dëshirave shumë e gjatë? Atëherë e keni gabim, sepse plazhi shkëmbor i Valdanosit i përmbushë të gjitha! Ndodhet 5 km në veriperëndim të Ulqinit, i vendosur midis dy kodrave. Plazhi mund të arrihet me makinë, por edhe në këmbë për të shijuar pamjen madhështore të ullishtave qindra vjeçare. Në këtë plazh shkëmbor të gjatë 400 metra ka një restorant, si dhe pllaka shkëmbi me shezllone në skajet e plazhit. Valdanosi është një vend i shkëlqyer për zhytësit, peshkatarët si dhe eksploruesit e detit. Gjithashtu një vend i njohur për lundrim për shkak të erërave të favorshme, por edhe një udhëtimi të këndshëm me biçikletë. Shtëpizat e drurit që gjenden në ullishtë, ju mundësojnë të jeni vetëm disa hapa larg nga realizimi i ëndrrave tuaja

Aty ku valët e detit gërryen muret e kalasë antike dhe fladi i freskët e ledhaton fytyrën, fillon një plazh i një qyteti të vogël. Në zemër të qytetit me një pamje mjaft tërheqëse tërheq turistë nga e gjithë bota. Plazhi me rërë kufizohet nga një shëtitore e gjerë që është ideale për njerëzit e moshave të ndryshme. Në mbrëmje, kjo pjesë e qytetit është plot gjallëri, muzikë dhe atmosferë rinore.

Hotel "Continental", i vendosur në Plazhin e Vogël, është një nga hotelet më të njohur në qytetin tonë bregdetar. Ai ofron akomodim të përshtatshëm për të gjithë. Hoteli ka një tarracë të madhe dhe një pamje qetësuese në det, ndërsa mysafirët kanë mundësinë të kalojnë një pushim të mrekullueshëm. Ballkonet janë të vendosura në secilën dhomë të hotelit, e cila ofron një pamje të bukur të detit dhe Qytetin e Vjetër.

Hotel Continental



Hotel Cruiser është një strukturë hotelierike që ofron akomodim të rehatshëm me një restorant në katin e parë. Në mënyrë të veçantë, Hotel Cruiser është një hotel dhe restorant i tipit të hapur, i destinuar për kategori të ndryshme të vizitorëve.

Hotel Cruiser



Rinovuar në vitin 2017, **Hoteli Mediteran** Ulcinj ofron një pishinë me pamje panoramike të detit dhe Kalasë së Ulqinit. Hoteli ndodhet pranë plazheve dhe vendeve për argëtim gjatë natës. Kompleksi me disa tarraca të bukura, një sallë konferencash për 125 persona dhe një sallë e madhe banketesh për evente deri në 500 persona.

Hotel Mediteran



Pylli i pishave është një nga vendet më të famshme në qytetin e Ulqinit. Përveç pamjes së veçantë, pylli me pisha ka dhe shumë benefite shëndetësore. Ajri i pastër dhe jodi që lirohet nga uji i detit, janë shërues për shumë njerëz, ndërsa plazhet e shumta shkëmbore që shtrihen përgjatë këtij brezi, janë ideale për aventura verore. Nëse dëshironi të relaksoheni, shijoni pamjen dhe qetësinë me familjen, Pylli i pishave është vendi i duhur për ju! Këtu ndodhet edhe hoteli i njohur Albatros i cili ofron një restorant me kuzhinë nacionale, diskotekë, fushë tenisi dhe shumë shërbime të tjera që do të kënaqin çdo nevojë tuajën.



Pylli i pishave

Plazhi i grave është një nga plazhet më të njohura shkëmbore në Ulqin. Është i mbuluar me pisha që pengojnë pamjen nga jashtë dhe, siç tregon vetë emri, vetëm gratë lahen në këtë plazh. Është veçanërisht i njohur për ujin sulfurik që buron atje. Legjenda thotë se uji në këtë plazh ndihmon në shërimin e sëmundjeve të ndryshme dhe se bën mrekulli që asnjë mjek në botë nuk mund t'ia arrijë.



Plazhi i grave

Higo Restaurant & Lounge në Ulqin është ndërtuar me shumë kujdes dhe kreativitet. Emërtimi "Higo" në gjuhën spanjolle do të thotë fik. Përse emri fik? Sepse në hyrje të restorantit ndodhet një fik i cili është i vjetër më shumë se 200 vite. Asnjë degë e pishave nuk është prirë gjatë ndërtimit. Ata që e njohin detin dhe këtë klimë, që e dinë se çfarë është ushqimi i mirë, për hedonistët që kërkojnë gjithmonë "diçka më shumë" nga ushqimi, me gastronomi moderne e me përvojë, do të përjetojnë përsosjen e këtij kombinimi në këtë vend.



Higo Restaurant & Lounge





NEW HORIZON
Civil Society Organization

+382 68 300 603

www.ngo-horizonti.org

New Horizon NGO

ngohorizonti@t-com.me

[newhorizonngo](https://www.facebook.com/newhorizonngo)

[newhorizon_ngo](https://www.instagram.com/newhorizon_ngo)